



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7904 prot.

Himarë, më 21.10. 2025

VENDIM

Nr. 51. Datë 17/10/2025

PËR

“DEKLARIMIN E MBARIMIT PARA KOHE TË MANDATIT TË KËSHILLTARIT
Z. FUAT MATI”

Mbështetur në shkronjën b të pikës 4 dhe pikës 5 të nenit 49 dhe neni 54 të ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.10019/2008 “Kodi Zgjedhor” si dhe “Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak Himarë, me propozim të Komisionit të Mandateve, pranë Këshillit Bashkiak Himarë: Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 17.10.2025, pasi shqyrtoi materialin e miratoi me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

- 1- Deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltarit z. Fuat Mati, për arsye të dorëheqjes.
- 2- Ky vendim t’i njoftohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sekretari i Këshillit bashkiak Himarë dhe Komisioni i Mandateve, pranë Këshillit Bashkiak Himarë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Dhimitër Kapaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I MANDATEVE

Nr. 7816 prot.

Himarë, më 17.10. 2025

Lënda: Propozim për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltarit z. Fuat Mati.

KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

Nisur nga kërkesa e këshilltarit z. Fuat Mati, me nr.6776prot., më 04/09/2025, me objekt; "Dorëheqje nga pozicioni i këshilltarit, në Këshillin Bashkiak Himarë", në mbështetje dhe zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", shkronja b e pikës 4 dhe pikës 5 të nenit 49, i propozojmë Këshillit Bashkiak Himarë, deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit z. Fuat Mati.

Kryetari:


Gerard Hiasli

Anëtar:

Thelëza Kokavris

Anëtar:

Nertila Hus



**DORËHEQJE NGA DETYRA SI KËSHILLTAR I KËSHILLIT TË BASHKISË
HIMARË**

DREJTUAR: Kryetarit të Këshillit të Bashkisë Himarë.

LENDË: Dorëheqje nga detyra si Këshilltar i Këshillit të Bashkisë Himarë

I nderuar z. Kryetar,

Me anë të kësaj letre, ju informoj se **jap dorëheqjen time të parevokueshme** nga pozicioni i Këshilltarit në Këshillin e Bashkisë Himarë.

Ky vendim vjen pas një reflektimi të kujdesshëm dhe është marrë për arsye personale/profesionale që e bëjnë të pamundur vijimin e angazhimit tim në këtë detyrë. Gjatë kohës sime si anëtar i Këshillit, kam bërë përpjekje të sinqerta për të kontribuar në të mirën e komunitetit dhe zhvillimin e Bashkisë Himarë.


Ju falënderoj për bashkëpunimin dhe për mundësinë për të qenë pjesë e këtij institucioni përfaqësues.

Ju lutem merrni masat përkatëse për të proceduar me zëvendësimin tim sipas ligjit dhe rregullores në fuqi.

Me respekt,

Fuat Mati

BASHKIA HIMARË



Datë. _ _ / _ _ / 2025

Lënda: Vënie në dijeni, për vijim procedurash.

**KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË
KRYETARIT TË KËSHILLIT
Z. DHIMITËR KAPAJ**

**KOMISIONIT TË MANDATEVE PRANË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË
KRYETARIT TË BASHKISË HIMARË
Z. VANGJEL TAVO**

I nderuar Kryetar i Këshillit ! Të nderuar këshilltarë!

Unë, e nënshkruari z. Fuat Mati, në detyrën Këshilltar i Këshillit Bashkiak Himarë, përmes këtij dokumenti ju bëj me dije zyrtarisht dorëheqjen time nga ky funksion, process të cilin e kam kryer përmes shkresës nr.6776prot., më 04/09/2025 depozituar pranë sekretarisë së Bashkisë Himarë.

Vendimi im për të dhënë dorëheqjen është marrë pas një reflektimi të kujdesshëm dhe bazohet në arsye profesionale që nuk lidhen me ndonjë pakënaqësi ndaj institucionit apo kolegëve të mi. Në respekt të afatit 5 ditor nuk kam ndërmarrë asnjë veprim në pritje të reagimit nga ana e Këshillit Bashkiak Himarë. Duke qënë se kam parë të arsyeshme ofertën për punësimin tim në një pozicion public pranë Bashkisë Himarë dhe në mënyrë të tillë që të mos kem ndikime në funksionin që kam marrë si Administrator i Njesisë Administrative Lukovë, ju kërkoj të veproni në bazë dhe për zbatim të ligjit lidhur me vakancën që është krijuar në Këshillin Bashkiak.

Përsa më sipër në bazë dhe për zbatim të ligjit i kërkoj Këshillit Bashkiak Himarë dhe Komisionit të Mandateve pranë Këshillit Bashkiak Himarë të vijojnë me të gjithë procedurat që duhet të ndiqen në mënyrë të tillë që të mos pengohet puna e Këshillit.

Dua të falënderoj drejtuesin e këshillit, anëtarët e këshillit për bashkëpunimin dhe mbështetjen gjatë ushtrimit të detyrës sime, si dhe administratën e Bashkisë.

Ju uroj suksese të mëtejshme në punën tuaj!

Me respekt!

KËSHILLTARI

Fuat Mati

BASHKIA
REPR
HIMARË